



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

**Tiranë më, 09.06.2020**

**Dokument parlamentar**

**RAPORT**  
**PËR DEKRETIN NR. 11483, DATË 15.05.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË, PËR “KTHIMIN E LIGJIT NR. 43/2020 “PËR AKTIVITETET E**  
**TURIZMIT DETAR”.**

**I. HYRJE**

Me dekretin nr.11483, datë 15.05.2020, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”.

Projektligji “Për aktivitetet e turizmit detar” është një propozim i Këshillit të Ministrave, i cili është shqyrtuar, në cilësinë e komisionit përgjegjës, nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Ligji 43/2020 është miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të datës 23 prill 2020.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr. 11483, datë 15.05.2020, të Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës 9 qershor 2020.

Komisioni caktoi deputeten Eglantina Gjermani relatore për dekretin.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të Institucionit të Presidentit të Republikës, Z. Bledar Dervishaj dhe Znj. Katrin Treska, Ministri i ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Z. Blendi Klosi dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

## **II. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

#### *Neni 85*

- 1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
- 2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

### **Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

#### *Neni 86*

#### *Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji*

- 1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.*
- 2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.*
- 3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.*
- 4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.*
- 5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.*
- 6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.*
- 7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.*
- 8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.*
- 9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.*

### **III. ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Në arsyet e kthimit të ligjit, Presidenti, arsyeton se:

1. Ligji nr. 43/2020, duke filluar nga dispozita e përkufizimeve, apo në tekstin integral të tij, përmban terma dhe fjalë që nuk janë në gjuhën shqipe, si : "surf", "windsurf", "wake board", "kit surfing ", "bare boat", etj., përdorimi i të cilave bën që ligji në tërësi të jetë në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , që përcakton se: "Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja".
2. Ligji nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar" nuk përcakton rregulla të qarta dhe të kuptueshme, referuar të drejtave dhe detyrimeve që kanë subjektet e tij, duke bërë që shumë dispozita të tij deleguese për rregullimin e çështjeve me akte nënligjore, të jenë në kundërshtim me nenin 11 dhe 118 të Kushtetutës, duke sjellë dhe implikime që lidhen me pasigurinë juridike dhe cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike.
  - 2.1 Mungesa e qartësisë së vullnetit të shprehur të ligjvënësit, që rregullat që duhet të përcaktohen në ligj, ia ka deleguar për rregullim me akt nënligjor Këshillit të Ministrave, pa përcaktuar çështjet konkrete që duhen rregulluar dhe parimet që do të udhëheqin nxjerrjen e këtyre rregullave, jo vetëm që cenon kërkesat e nenit 118, paragrafi 2, i Kushtetutës, por krijon dhe një gjendje të theksuar pasigurie ligjore për operatorët e veprimtarive të turizmit detar, duke rritur edhe rrezikun e trajtimit preferencial të operatorëve, mbi kriteret subjektive që qeveria herë pas here mund t'i ndryshojë, sipas vullnetit politik të kohës.
  - 2.2 Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për certifikimin e operatorëve turistik, pa përcaktuar asnjë kriter apo parim, qoftë dhe orientues për nxjerrjen e tyre, cenon nenin 118, paragrafi 2, i Kushtetutës. Delegimi i pakufizuar dhe shmangia nga përcaktimi në këtë ligj i kriterëve dhe procedurave të certifikimit, që lidhen direkt me të drejtën për të ushtruar veprimtarinë si operator i turizmit detar, krijon pasiguri juridike për ndryshimin e këtyre kriterëve dhe procedurave sipas vullnetit politik të një ministri, duke sjellë implikime direkte ndaj lirisë së veprimtarisë ekonomike, të mbrojtur nga neni 11 i Kushtetutës.
  - 2.3 Neni 24 i ligjit nr. 43/2020 që trajton kundërvajtjet administrative dhe mënyrën se si masat administrative ndëshkimore do të aplikohen, bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe paraqet problematikë dhe pasiguri të theksuar juridike. Për më tepër, procedura ligjore se si do të aplikohet një masë administrative e heqjes së lejes/licencës/certifikatës, nuk është parashikuar në këtë ligj. Ligji nuk e përcakton në mënyrë të shprehur që gjopa përbën titull ekzekutiv, prandaj procedura e ekzekutimit duhet t'i referohet parimeve të Kodit të Procedurës Civile lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm i titujve ekzekutiv.
  - 2.4 Fjalja e fundit e pikës 3, të nenit 24 parashikon se: "Në rast përsëritje të shkeljeve të mësipërme, subjektet u nënshtrohen procedurave ligjore deri në shfuqizimin e

lejes/licencës/certifikatës përkatëse ", por nuk parashikon asnjë procedurë apo mjetet e ankimit se si mund të zhvillohet ky proces administrativ deri në vendimmarrjen përfundimtare për heqjen e lejes/licencës/certifikatës.

2.5 Neni 27 që parashikon se: "Çdo dispozitë e akteve ligjore, që bie ndesh me parashikimet e këtij ligji, shfuqizohet dhe institucionet përgjegjëse ngarkohen për rishikimin e kuadrit ligjor në fuqi." shkel nenin 116 të Kushtetutës që përcakton hierarkinë e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë.

#### **IV. DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr.11483, datë 15.05.2020, të Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës 9 qershor 2020.

Arsyet e kthimit të ligjit nga Presidenti i Republikës u prezantuan në mënyrë të përmbledhur nga përfaqësuesit e institucionit të Presidentit.

Lidhur me çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit të Republikës, u shpreh relatorja, e cila paraqiti argumentet dhe vlerësimet për arsyet e parashtruara, si më poshtë vijon:

1. Lidhur me argumentin e shkeljes se nenit 14 të Kushtetutës, për shkak të përdorimit të termave dhe fjalëve që nuk janë në gjuhën shqipe:

Së pari, përdorimi i këtyre termave të përcaktuar në nenin 3 të ligjit është trajtuar dhe diskutuar gjerësisht në analizën e bërë që përpara hartimit të projektligjit, edhe me specialistë të fushës së turizmit. Konkluzioni i arritur nga hartuesit dhe ekspertët ishte se nuk ka emërtime specifike në gjuhën shqipe për këto terma. Ato që Presidenti i konsideron si fjalë të huaja në këtë ligj, janë terma ndërkombëtare të përdorura në sektorin e turizmit detar. Fusha e turizmit në përgjithësi, ashtu si dhe ajo e turizmit detar, janë fusha specifike ku përdorimi i termave ndërkombëtare për veprimtaritë që përfshihen në to është i pashmangshëm dhe i njëjtë në të gjithë botën. Për këto arsye, mbështetur në parimin e qartësisë dhe kuptueshmërisë së aktit, në ligj u janë dhënë përkufizime shteruese.

Së dyti, përdorimi i këtyre termave në ligj harmonizohet edhe me përcaktimet e nenit 6 të ligjit Nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i cili në pikën 3 dhe 4, përcakton se: "Termet e së drejtës ndërkombëtare detare kanë kuptimin që jepen prej saj dhe shënohen në kllapa pas termit në shqip, përveç kur nuk ka të tillë". Kuptimi i termave detarë, sipas këtij Kodi, është i detyrueshëm për fushat e tjera të së drejtës".

Për këto arsye, edhe në ligjin nr 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar, ligji kuadër në fushën e turizmit, janë përdorur gjithashtu terma ndërkombëtarë, për shkak të mungesës së tyre në gjuhën shqipe dhe nevojës së harmonizimit me përcaktimet e Kodit Detar.

2. Lidhur me argumentin se ligji 43/2020 nuk përcakton rregulla të qarta dhe të kuptueshme, referuar të drejtave dhe detyrimeve që kanë subjektet e tij, duke bërë që shumë dispozita të tij delegeuse për rregullimin e çështjeve me akte nënligjore, të jenë në kundërshtim me nenin 11 dhe 118 të Kushtetutës, duke sjellë dhe implikime që lidhen me pasigurinë juridike dhe cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike:

Megjithëse Presidenti pretendon se përcaktimet e nenit 4, pika 2 të projektligjit cenojnë kërkesat e nenit 11 të Kushtetutës (liria e veprimtarisë ekonomike), nuk ka sjellë asnjë argument për mënyrën sesi realizohet ky cenim nëpërmjet parashikimeve të nenit 4 të ligjit. Ky arsyetim mbetet thjesht teorik, madje paragjyket në raport me aktin nënligjor që do të nxjerrë qeveria, kur shprehet për një “trajtim preferencial”, pa mundur të argumentohet realisht në aspektin ligjor, e për më tepër në raport me cenimin e pretenduar.

- 2.1.Lidhur me çështjen e delegimit për rregullim me akt nënligjor, Këshillit të Ministrave, pa përcaktuar çështjet konkrete që duhen rregulluar dhe cenimin e nenit 11 dhe 118/2 të Kushtetutës;

Në bazë të nenit 118, pika 2 të Kushtetutës, ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin, kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Pra, në rastet e rezervës ligjore relative, qeveria ndërhyt me pushtet normativ, por vetëm atëherë kur ligji ka vendosur linjat dhe parimet themelore të çështjes që nevojitet të rregullohet. Kjo lloj rezerve ligjore pranon ndërhyrjen e pushtetit normativ të qeverisë apo ministrit nëpërmjet vendimeve të autorizuar me karakter organizues dhe zbatues, meqë çështja që nevojitet të rregullohet është e një natyre të tillë që pranon përcaktim legjislativ rregullues në parim.

Në përputhje me përcaktimet Kushtetuese, parimet e doktrinës juridike dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, duke mbajtur në konsideratë se kemi të bëjmë me një akt normativ kuadër, ligjvënësi në përputhje me qëllimin e përcaktuar në nenin 1, të ligjit, i ka deleguar Këshillit të Ministrave kompetencën për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 3, të ligjit. Qëllimi i ndërmarrjes së kësaj nisme vjen pikërisht në përputhje me parimin kushtetues të lirisë ekonomike, të përcaktuar në nenin 11, të Kushtetutës. Por, liria e veprimtarisë ekonomike përmban njëkohësisht edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Shih Vendimi nr.10, datë 19.03.2008 i Gjykatës Kushtetuese

Nga ana tjetër, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit, nisur nga konteksti i tyre dhe nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, rezulton se arsyetimi mbi cenimin e sigurisë juridike nuk qëndron dhe është paragjykses, sa kohë delegimi për nxjerrjen e aktit është bërë konform parashikimit të pikës 2, të nenit 118 të Kushtetutës, pasi ka përcaktuar qartë a) llojin e aktit nënligjor që do të dalë; b) organin kompetent; si dhe c) çështjet që duhen rregulluar nëpërmjet nxjerrjes së këtyre akteve nënligjore.

Referuar sa më sipër, rezulton se akti përmban të gjithë elementët thelbësore për garantimin e sigurisë juridike të subjekteve, duke parashikuar rregullime ligjore të qëndrueshme dhe të mjaftueshme që sigurojnë vijimësinë e tyre.

2.2 Lidhur me argumentin se delegimi i pakufizuar dhe shmangia nga përcaktimi në këtë ligj i kriterëve dhe procedurave të certifikimit, që lidhen direkt me të drejtën për të ushtruar veprimtarinë si operator i turizmit detar, krijon pasiguri juridike për ndryshimin e këtyre kriterëve dhe procedurave sipas vullnetit politik të një ministri, duke sjellë implikime direkte ndaj lirisë së veprimtarisë ekonomike, të mbrojtur nga neni 11 i Kushtetutës:

Në ligj është përcaktuar se operatorët e turizmit detar duhet të jenë licencuar sipas kushteve dhe përcaktimeve të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe se përveç licencimit, para fillimit të aktiviteteve të turizmit detar, operatori i turizmit detar do t’i nënshtrohet edhe procedurës së marrjes së një certifikate nga ministria përgjegjëse për turizmin. Ky kusht vjen si një element thelbësor për verifikimin e plotësimit të kushteve nga subjektet që do të ushtrojnë aktivitete të turizmit detar, në funksion të një verifikimi dhe certifikimi si subjekte të përshtatshme për kryerjen e këtyre aktiviteteve, për shkak të përmbushjes së disa kriterëve në funksion të sigurisë dhe qëndrueshmërisë të zhvillimit të tyre. Duke qenë se, si operatori turistik ashtu dhe operatori i turizmit detar janë subjekte brenda fushës së turizmit, është kjo ministri në cilësinë e institucionit përgjegjës për fushën e turizmit, që përcakton kriteret e certifikimit. Për më tepër, si sektori i turizmit dhe ai i turizmit detar, është një sektor dinamik që synon të shkojë në hapin e zhvillimeve dhe risive ndërkombëtare dhe si i tillë sigurisht që do të duhet të krijojë edhe rregulla lehtësisht të përshtatshme me to.

Për të gjitha këto arsye, ligji ia delegon ministrisë përgjegjëse hartimin dhe miratimin e kriterëve dhe procedurës për certifikimin, në respektim edhe të kërkesave të nenit 118 të Kushtetutës.

Sa më sipër, Kuvendi, në përputhje me përcaktimet Kushtetuese, parimet e doktrinës juridike dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, në ushtrim të përgjegjësive të tij kushtetuese, ka përcaktuar në ligj parimet në bazë të të cilave do të zhvillohen veprimtaritë e turizmit detar dhe vetëm atëherë kur ligji i ka përcaktuar këto linja dhe parime, ka aplikuar parimin e rezervës ligjore relative, duke i deleguar ministrit përgjegjës kompetencën për miratimin e rregullave të hollësishme që duhet ndjekin operatorët që do të zhvillojnë veprimtarinë në fushën e turizmit detar.

2.3 Lidhur me argumentin se neni 24 i ligjit nr. 43/2020 që trajton kundërvajtjet administrative bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile :

Së pari, pika 2 e nenit 24 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 43/2020, referon shprehimisht në përcaktimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimet, për procedurat e konstatimit, të vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobave. Në nenin 22, pika 1, ky ligj përcakton se: “Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga institucionet e organizuara si inspektorate shtetërore, pavarësisht nga mënyra e organizimit të tyre dhe nga objekti i veprimtarisë, përbëjnë titull ekzekutiv”. Ndërkohë që, neni 24, pika 1 parashikon se: “Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ që ka kompetencën për shqyrtimin përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative”.

Po kështu, neni 23 i ligjit 43/2020, në pikën 1 përcakton se :“Inspektimi i aktiviteteve të turizmit detar, operatorit të turizmit detar dhe i mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin nga strukturat përgjegjëse inspektuese, sipas fushave të veprimtarisë përkatëse”.

Pra, nga kjo analizë ligjore rezulton se ligji 43/2020 është plotësisht i harmonizuar me përcaktimet e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, lidhur me përcaktimin e gjobës si titull ekzekutiv dhe se referimi në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është i gabuar.

2.4. Lidhur me argumentin se ligji 43/2020 nuk parashikon asnjë procedurë apo mjetet e ankimit se si mund të zhvillohet procesi administrativ deri në vendimmarrjen përfundimtare për heqjen e lejes/licencës/certifikatës:

Së pari, procedura për heqjen e licencës i nënshtrohet përcaktimeve të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, pasi në nenin 5, pika 2 të ligjit 43/2020 përcaktohet se licencimi i operatorëve të turizmit detar bëhet në përputhje me legjislacionin për licencat. Ndërsa, procedura e shfuqizimit të certifikatës bazohet në përcaktimet e Kodit të Procedurave administrative, për sa kohë që, certifikata është një akt administrativ individual në kuptim të këtij Kodi. Rrjedhimisht, edhe procedura e ankimit për heqjen e saj do t’i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në KPA.

Së dyti, procedura e ankimit administrativ në lidhje me licencat dhe lejet është e parashikuar në pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr.43/2020:

*“2. Ankimi administrativ, në lidhje me licencat, bëhet në përputhje me përcaktimet në dispozitat e ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”*

Ndërkohë që, pika 3 e nenit 25 të ligjit, përcakton edhe të drejtën e subjektit për t’iu drejtuar gjykatës administrative pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ.

*“3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”*

Referuar ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjes administrative”, të ndryshuar, i cili parashikon rastet e shterimit të ankimit administrativ dhe dërgimit të çështjes direkt në gjykatë, **padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet direkt në gjykatë kur ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrative.** Duke qenë se ky dokument do të lëshohet nga ministri përgjegjës i turizmit, atëherë, automatikisht subjekti ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës.

Nga analiza e dispozitave të ligjit 43/2020, sa më sipër, rezulton se ligji e ka të përcaktuar shumë qartë, së pari, procedurën për heqjen e licencës dhe certifikatës dhe së dyti, procedurën e ankimit në këto raste.

2.5. Lidhur me argumentin se dispozita e shfuqizimit të akteve shkel nenin 116 të Kushtetutës që përcakton hierarkinë e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë:

Dispozita e nenit 27 të ligjit nr. 43/2020 shfuqizon aktet ligjore të të njëjtit nivel hierarkik, pikërisht për shkak të përcaktimeve të nenit 116 të Kushtetutës, pasi nuk ka fuqi ligjore të shfuqizojë një akt të miratuar me shumicë të cilësuar, duke qenë se ai qëndron në nivel hierarkik më të lartë. Megjithatë, kjo dispozitë ka ngarkuar institucionet përgjegjëse të rishikojnë kuadrin ligjor në fuqi dhe është në tagrin e tyre të bëjnë analizën përkatëse në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke qenë se ky ligj prek disa fusha dhe konsiderohet si akt normativ kuadër, në fushën e aktiviteteve të turizmit detar.

***Në përfundim***, bazuar në sa më sipër, relatorja, pasi vlerësoi se:

- Në Dekretin nr.11483, datë 15.05.2020, të Presidentit të Republikës, mungon argumentimi i pretendimit për papajtueshmëri të dispozitave të ligjit me parimet kushtetuese, ndërkohë që argumentet e paraqitura janë teorike dhe të nivelit teknik;
- dispozitat e ligjit 43/220, nuk cenojnë asnjë parim kushtetues dhe janë plotësisht të harmonizuara me legjislacionin në fuqi;

I propozoi komisionit rrëzimin e Dekretit të Presidentit.

**Në përfundim të diskutimeve**, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, vendosi **rrëzimin e Dekretit** nr.11483, datë 15.05.2020, “Për “kthimin e ligjit 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar” dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

**RELATORE**

**Eglantina GJERMENI**

**KRYETAR**

**Niko PELESHI**